

Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova Civil Aviation Authority of Kosovo		
CAA		
Nr. i prot. 2022/ZDP/386		
Br. prot./Prot.Nr. 7	Kopje: ARKIV	Datë: 19/12/2022
Stranica/Pages	Kopija/Copy	Datum/Date
Hyrës/ulaznin	☐	
Dalës/izlazo/out	☒	
Brendshëm/intermo/internal	☐	
Prishtinë/Priština/Pristina		

Nr. 11/ZDP/VE/2022
Datë: 16 dhjetor 2022

Në mbështetje të nenit 14.1, 14.2, 15.1(f), 21.2 dhe 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për Aviacionin Civil ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 4 qershor 2008), nenit 41 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 7, dt. 1 mars 2019"), nenit 13 dhe 15 të Rregullores së AAC-së nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, dt. 10 shkurt 2016 ("Rregullorja") dhe nenit 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28, dt. 28 prill 2014),

Duke vendosur sipas propozimit final të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror ("ASHNA"), dt. 4 nëntor 2022, për tarifën njësi terminale për vitin 2023,

Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet miratimi i tarifës njësi terminale 2023 prej 508 EUR siç është propozuar nga ASHNA më dt. 4 nëntor 2022.
2. Përcaktohet tarifa njësi terminale 2023 në Republikën e Kosovës në vlerë prej 380 EUR.
3. Kjo tarifë u ngarkohet kompanive ajrore nga ASHNA për shërbimet terminale të navigacionit ajror që Agjencia ofron në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës duke filluar nga data 1 janar 2023.
4. Obligohet ASHNA që të kërkojë aprovim nga AAC për çdo ndryshim në investimet kapitale të aprovuara që të financohen me tarifën njësi terminale 2023.
5. Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

ARSYETIM

Me qëllim të vlerësimit të propozimit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2023, AAC-ja ka marrë parasysh dokumentacionin si në vijim:

- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të parë (kostoja bazë fillestare për të dhënë shërbimin në vitin 2023 përmes tabelave të raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores 3/2016), më dt. 25 mars 2022 me numër protokolli 2022/BNRREA/85;

- Konkluzionet e AAC-së nga përmbyllja e shqyrtimit rregullator të raportimit të parë të ASHNA-së sa i përket tarifës njësi 2023 të cilat i janë komunikuar më 20 prill 2022;
- Raportin mbi pasqyrat financiare të ASHNA-s të dt. 13 maj 2022 për vitin financiar të përfunduar më 31 dhjetor 2021 dhe Raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të publikuar në maj 2022 për pasqyrat financiare të ASHNA-s për vitin 2021;
- Dokumentet e dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbim gjatë vitit 2023 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), më dt. 31 gusht 2022 me numër protokolli 2022/ZDP/259;
- Dokumentet e përditësuara të dorëzuara nga ASHNA gjatë raportimit të dytë të plotësuar e ndryshuar (kostoja bazë përfundimtare për të dhënë shërbimin gjatë vitit 2023 përmes tabelave të Raportimit nga shtojca II dhe VI e Rregullores), më dt. 4 nëntor 2022 me numër protokolli 2022/ZDP/345;
- Planin e aprovuar të trajnimeve të ASHNA-s për vitin 2023, i dërguar në AAC më 2 nëntor 2022;
- Planin vjetor të biznesit për vitin 2023 të ASHNA-s të dt. 15 nëntor 2022 me numër protokolli 2022/BNRREA/350;
- Planin 5 vjeçar të biznesit (2023-2027) të ASHNA-s të dt. 15 nëntor 2022 me numër protokolli 2022/BNRREA/351;
- Qarkoren buxhetore 2023/01 të MFPT, dt. 13 maj 2022, Qarkoren buxhetore 2023/02, dt. 11 tetor 2022 si dhe kërkesën buxhetore të ASHNA-s për vitet 2023-2025 drejtuar MFPT të dt. 24 qershor 2022;
- Projektligjin mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023, siç është miratuar nga Qeveria e RKS më 1 nëntor 2023;
- Raportin e shpenzimit të Buxhetit janar-nëntor për ASHNA-n të dërguar nga MFPT më dt. 2 dhjetor 2022;
- Raport mbi realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve janar-gusht 2022 të dorëzuar më dt. 24 gusht 2022 si dhe raportin mbi realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve janar-nëntor 2022 të dorëzuar më dt. 30 nëntor 2022;
- Komunikimin elektronik me LKIA lidhur me parashikimin e trafikut deri në fund të vitit 2022 dhe për vitin 2023, të dt. 7 nëntor 2022 si dhe takimin me LKIA për këtë qëllim të datës 11 nëntor 2022;
- Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2022 të dorëzuar nga ASHNA më 9 nëntor 2022;
- Të gjeturat nga inspektimi i datës 24 nëntor 2022 në ASHNA në lidhje me realizimin e projektit kapital "Pjesë rezervë për sisteme radarike" të financuar nga TNC 2022;
- Raportin mbi propozimin e tarifës terminale njësi 2023 të hartuar nga ASHNA dhe të shpërndarë te kompanitë ajrore për konsultime në pajtim me nenin 15 të Rregullores nr. 3/2016 të AAC-së, dt. 8 nëntor 2022;
- Raportimin nga ASHNA të dt. 29 nëntor 2022 se pas përmbylljes së afatit tre javor të konsultimit publik (8 nëntor - 28 nëntor 2022) dhe takimit të mbajtur më 29 nëntor 2022 me kompanitë ajrore (Turkish Airlines) në lidhje me përcaktimin e tarifës terminale, nuk kanë pranuar asnjë koment nga kompanitë ajrore;
- Takimin me ASHNA të datës 24 tetor 2022, 29 nëntor 2022 dhe 5 dhjetor 2022 në lidhje me propozimin e tyre për koston e ofrimit të shërbimit në vitin 2023;
- Informatat dhe dokumentacionin që është pranuar nga ASHNA përmes komunikimit elektronik në periudhën shtator-nëntor 2022 me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi terminale për vitin 2023 gjatë periudhës së shqyrtimit;

Pas shqyrtimit rregullator të secilës prej kategorive të kostove të propozuara si dhe parashikimit të njësisë që pritet të shërbehen gjatë vitit 2022, BNRREA ka konkluduar si në vijim:

Kostot për paga dhe mëditje:

ASHNA ka propozuar një kosto prej 3.52 milion EUR për paga dhe mëditje që përfshin edhe pagesat për punë jashtë orarit, shtesa, kontribute pensionale si dhe një rritje page për 10% për vitin 2023. Kjo kosto përfaqëson një rritje prej 23% në krahasim me përcaktimin e AAC-së për këtë kategori për vitin 2022. Kostoja e propozuar është rritur, mes tjerash, për shkak të 12 punëtorëve shtesë (student kontrollorë të trafikut ajror) si dhe për shkak të planifikimit që pagat të rriten për 10% në vitin 2023. ASHNA ka planifikuar të operojë më 2023 me gjithsejtë 192 punëtorë.

Duke pasur parasysh kërkesën e Rregullores, sipas të cilës vetëm kosto e stafit që pritet të japin shërbimin gjatë vitit 2023 duhet t'i ngarkohet kompanive ajrore, AAC-ja ka bërë një kalkulim vetanak në të cilin janë marrë parasysh: a) pamundësia që në shërbimin civil të fillojnë punën 12 pozitat shtesë që nga muaji i parë i vitit 2023, b) pagat e stafit që do të kthehen nga pushimet pa pagesë (Menaxheri i zyrës së Drejtorit) vetëm për muajt që do ta japin shërbimin si dhe c) shtesat në pagë dhe kompensimet tjera. Sa i përket rritjes së planifikuar për 10%, ASHNA nuk ka ofruar dëshmi se një rritje e tillë e pagës i është aprovuar nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe ajo e Financave andaj edhe nuk është pranuar si kosto e arsyeshme nga ana e AAC-së.

Pas shqyrtimit të kostos së shtesave të cilat çdo vit janë të mëdha e për këtë vit është paraparë në shumën prej 386,684 EUR, AAC kërkon që ASHNA të rrisë nivelin e mbikëqyrjes sidomos mbi nevojën për të punuar stafi jashtë orarit.

AAC-ja ka përcaktuar si të arsyeshme një kosto prej 2.96 milion EUR për paga, shtesat në pagë dhe kompensimet tjera. Numri i përcaktuar i personelit është 192 aq sa ka propozuar ASHNA.

Kostot tjera operative:

ASHNA ka parashikuar që kostot operative të jenë 2.44 milion EUR gjatë vitit 2023 apo 61% më shumë se sa ka përcaktuar AAC-ja për vitin 2022.

Duhet theksuar që edhe sivjet parashikimi i këtyre kostove nga ASHNA është përshkruar me jokonsistencë për shkak se këto kosto vazhdimisht kanë pësuar ndryshime duke demonstruar planifikim jo të duhur. Në raportimin e parë ASHNA ka parashikuar kosto prej 2.25 milion EUR, në raportimin e dytë 2.44 milion EUR ndërsa në raportimin e dytë të plotësuar e ndryshuar ka paraqitur dy tabela në excel me kostot operative, njëren 1.77 milion EUR dhe tjetrën 2.41 milion EUR. AAC ka shqyrtuar listën e shpenzimeve operative që mban vlerën totale prej 2.41 milion EUR në të cilën ka vërejtur se linjat me koston më të lartë janë Trajnimet (720,000 EUR) dhe Mirëmbajtja (642,000 EUR). Gjithashtu janë vërejtur disa linja të reja që janë përfshirë te mirëmbajtjet e që nuk kanë figuruar në vitet paraprake, kosto këto të cilat janë pranuar pas sqarimit nga ASHNA se këto janë kosto për mirëmbajtjen e sistemeve të reja të instaluar (marrëveshjet mbi nivelin e shërbimit etj).

Sa i përket trajnimeve ASHNA fillimisht kishte paraqitur si kosto të trajnimeve një vlerë prej 480,000 EUR, ndërsa gjatë raportimit të dytë kishte paraqitur si kosto 720,000 EUR. Sidoqoftë, Plani i Trajnimeve i nënshkruar i cili është dorëzuar më 2 nëntor 2022 ka kosto prej 566,750 EUR, kosto kjo e pranuar nga AAC duke pasur parasysh, mes tjerash, trajnimin e gjeneratës së re prej 12 kontrollorëve i cili planifikohet të fillojë më 2023.

Pasi ka shqyrtuar secilën linjë të kostove operative të parapara për vitin 2023, raportin e realizimit të buxhetit gjatë vitit 2022, nivelin e lartë të inflacionit gjatë vitit 2022 dhe parashikimin për inflacion gjatë vitit 2023, AAC-ja ka përcaktuar si të arsyeshëm një buxhet operativ prej 2.28 milion EUR për vitin 2023 që përfshin kostot operative dhe shpenzimet komunale rreth 122,000 EUR.

Kostoja e zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit:

ASHNA ka propozuar që kosto e kapitalit dhe zhvlerësimit për vitin 2023 të jetë 696,673 EUR. Në listën e rregulluar të aseteve aktuale të ASHNA, AAC ka vërejtur që disa asete nuk janë zhvlerësuar sipas formulës në excel prandaj edhe kostoja e kalkuluar nga AAC për zhvlerësimin e aseteve aktuale është e ndryshme (557,147 EUR). Kostoja e kapitalit nuk është llogaritur saktë. Vlera prej 775,000 EUR e aseteve shtesë për vitin 2021 e vendosur nga ASHNA e që ka impakt edhe në vitet në vazhdim nuk ka burim dhe nuk dihet se si është ardhë deri te kjo vlerë prandaj AAC ka bërë llogaritjen në bazë të formulave përkatëse me ç'rast për koston e kapitalit të aseteve ekzistuese është fituar vlera prej (125,526 EUR)

Sa i përket mesatares së ponderuar të normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali ASHNA ka propozuar që të jetë 3.40% duke u bazuar në përcaktimin e AAC-së për vitin 2022. Në bazë të shtojcës 3 Manualit të ICAO-s mbi ekonominë e shërbimeve të navigacionit ajror dhe seksionit 1 të pikës 4 të Udhëzuesit të EUROCONTROL-it mbi sistemin e tarifave të rutave, AAC-ja ka analizuar obligacionet qeveritare 7 dhe 10 vjeçare të Bankës Qendrore të Kosovës mesatarja e të cilave është 3.35%. Në bazë të këtyre të dhënave AAC-ja ka vendosur që mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe kthimit të kapitalit të jetë 3.35%.

Deri në lëshimin e këtij dokumenti, ASHNA, nuk ka mundur të realizojë projektin e aprovuar nga AAC-ja që të financohet me tarifën terminale 2022 "Pjesë rezervë për sisteme radarike". Gjatë inspektimit të dt. 24 nëntor 2022, ASHNA ka deklaruar që vlera e parashikuar nga tarifa për këtë projekt gjatë vitit 2022 mund të liferohet deri më 15 dhjetor 2022, mirëpo për shkak të kohës AAC ka vendosur që këtë projekt mos ta përfshijë në kalkulim të zhvlerësimit dhe koston së kapitalit për vitin 2023. Nëse realizohet atëherë do të bëhet përshtatja gjatë përcaktimit të tarifës terminale të vitit 2024.

Pas finalizimit të listës së rregulluar të aseteve, kalkulimit të zhvlerësimit dhe koston së kapitalit si për asetet që janë në funksion më 2023 ashtu edhe për ato që planifikohen të futen në funksion gjatë 2023 dhe aplikimit të normës prej 3.35%, AAC-ja ka përcaktuar që kosto e zhvlerësimit dhe kosto e kapitalit për vitin 2023 të jetë 726,336.31 EUR.

Projektet kapitale të aprovuara:

ASHNA ka planifikuar që të realizojë një projekt kapital, të financuar pjesërisht nga tarifa terminale 2023 në vlerë prej 789,237 EUR. Ky investim ka të bëjë me prokurimin e "Sistemit të ri të Procesimit të të Dhënave ATM", projekt ky me vlerë totale prej 4,935,991 EUR i cili parashihet të financohet në masë të madhe nga granti qeveritar në vitet 2023-2025. Pasi që ka vlerësuar arsyeshmërinë e tij të prezantuar nga ASHNA, AAC-ja ka miratuar këtë projekt.

Projekti	Vlera përgjithshme	Burimi i Financimit
Sistemi i ri i procesimit të të dhënave ATM	4,935,991 EUR	Grant Qeveritar 4,146,754 EUR
		Të hyrat e dedikuara 789,237 EUR

Në kuadër të kostos totale të zhvlerësimit dhe të kostos së kapitalit për vitin 2023, afro 43,673 EUR janë përfshirë si kosto për këtë projekt kapital me pritshmëri që të jetë në funksion në tremujorin e fundit të vitit 2023.

Parashikimi i njësive terminale të shërbimit (TSU) 2023:

ASHNA ka parashikuar rritje të TSU-ve prej 3% për vitin 2023, respektivisht ka parashikuar se do t'i shërbejë 12,164 njësi nga 11,809 njësi sa ka raportuar në Tabela Raportuese se do t'i shërbejë gjatë vitit 2022. Sidoqoftë, në Raportin preliminar të njësive terminale të shërbimit (TSU) për muajt nëntor dhe dhjetor 2022 të dorëzuar më 15 nëntor 2022, ASHNA ka raportuar se do t'i shërbejë 13,757 njësi gjatë vitit 2022 gjë që përbën dallim të madh prej 11,809 njësi sa i kanë deklaruar në Tabela Raportuese që ka ndikuar edhe në propozimin joreal të tarifës për vitin 2023. Poashtu nuk janë sqaruar se në bazë të çfarë burimi e kanë vendosur rritjen e parashikuar prej 3%. Parashikimi i saktë i bazës së TSU-ve (viti n) është me rëndësi për ASHNA pasi që parashikimi për vitin (n+1) ndërtohet mbi të ndërsa konstatimi i gabuar nënkupton axhustime të mëdha në vitin n+2. Vlen të theksohet se ASHNA ka planifikuar të shërbejë 12,164 njësi në vitin 2023 ndërsa vetëm deri në fund të nëntorit 2022 ka shërbyer 12,783 njësi gjë që edhe njëherë vërteton parashikimin jo të bazuar në të dhëna të TSU.

Operatori i aeroportit ka parashikuar se viti 2022 do të përmbyllet me afër 3 milion udhëtarë të shërbyer, (36.6% rritje në krahasim me 2021) respektivisht 10,737 nisje të fluturimeve (20.4% rritje). Ndërsa, sipas tyre, numri i udhëtarëve në vitin 2023 parashihet të ketë një ngritje më modeste prej 6.2% në krahasim me vitin 2022 ndërsa numri i fluturimeve të ngritet për 7.9%. Ky parashikim është bazuar në Orarin e fluturimeve për sezonin dimër 2022/2023 dhe aplikimeve të

pranuara nga kompanitë ajrore për sezonin verë 2023. Parashikimi është ndërtuar poashtu nën supozimet se në 10 muajt e parë të vitit 2023 pritet një zhvillim normal, por me një rënie për muajt nëntor dhe dhjetor për shkak të gjendjes shumë më të vështirë që pritet me furnizimin me energji në Evropë dimrin e ardhshëm. Njëkohësisht, me shumë gjasë liberalizimi i vizave nuk pritet të ndodhë para 1 janarit 2024.

AAC-ja ka bërë një kalkulim mbi trafikun dhe numrin e parashikuar të TSU-ve gjatë vitit 2023 duke u bazuar në të dhënat dhe parashikimin e trafikut nga operatori i aeroportit LKIA si të dhënat më mirë të informuara të numrit të fluturimeve. AAC-ja pret që viti 2022 të përmbyllet me 13,757 njësi terminale të shërbimit ndërsa gjatë vitit 2023 parashikon që do të shërbehen 14,719 njësi terminale që i bie 7% më shumë se në vitin 2022.

Përshtatja për vitin 2021:

Sa i përket përshtatjes, gjatë raportimeve ASHNA ka paraqitur mbi mbulim për vitin 2021 prej 138,161 EUR e që është keqkalkulim sepse nuk ka konsideruar vlerat e sakta të realizuara në vitin 2021, dhe nuk ka marrë parasysh mbetjet e vitit 2020 (Vendimi 11/ZDP/VE/2021) dhe 2019 (Vendimi 10/ZDP/VE/2020) të cilat AAC i ka shpërndarë në vite.

Në bazë të pasqyrave financiare të ASHNA-s të vitit 2021, përshtatjes përkatëse të zhvlerësimit dhe kostos së kapitalit për projektet kapitale të realizuara gjatë vitit 2021, si dhe vlerave që barten nga vitet e kaluara për shkak të mbi ose nënbulimit të shpenzimeve, rezulton se ASHNA ka mbyllur vitin me një bilanc prej 210,982 EUR, e cila vlerë do t'u kthehet kompanive ajrore në vitet n+2 (2023), n+3 (2024) dhe n+5 (2025), respektivisht nga 70,237 EUR çdo vit.

Kur kësaj vlere i shtohet mbimbulimi nga viti 2020 në vlerë prej 87,480 EUR dhe nënmbulimi nga viti 2019 në vlerë prej 127,159 EUR, del se vlera e cila ASHNA duhet t'ia kthej kompanive ajrore gjatë vitit 2023 është 30,649 EUR.

Sikurse viteve të kaluara prap duhet theksuar që ASHNA duhet të adresojë përbrenda faktin që nevojitet ekspertizë për të bërë saktë përshtatjen për vitin (n-2) në përputhje me pikën 5 të Udhezuesit të EUROCONTROL-it mbi mbi sistemin e tarifave të rutave për të evituar vazhdimin e llogaritjes së përshtatjes në mënyrë jo të saktë.

Në bazë të këtyre fakteve dhe konsiderimeve dhe duke pasur parasysh:

- Se propozimi i ASHNA-s për tarifë terminale 2023 në vlerë prej 508 EUR i llogaritur nën parashikimin e rritjes së njësive të shërbimit më 2023 për 3% nën bazën prej 11,809 njësive që përfaqëson një rritje tarife prej 22% krahasuar me tarifën e vitit 2022 në vlerë prej 418 EUR;
- Se ASHNA obligohet sipas Rregullores që të dëshmojë përpjekjet për përmirësimin e efikasitetit të kostove që në kushtet e rritjes së trafikut nënkupton ulje tarife;
- Vendimin nr. 05-V-286, dt. 26 maj 2016, përmes të cilit Kuvendi i Republikës së Kosovës ka udhëzuar AAC-në të ndërmarrë masat e nevojshme nga fushëveprimi i vet për të krijuar një konkurrencë më të madhe në funksion të uljes së çmimeve të udhëtimit;

- Se AAC-ja ka për qëllim që të vendosë një balancë midis operatorëve që japin shërbime nën kushtet e monopolit natyror dhe atyre që i pranojnë këto shërbime;
- Nxitjet financiare të ofruara nga operatori i aeroportit dhe të aprovuara nga AAC-ja për të rritur atraktivitetin e aeroportit;
- Krizën nëpër të cilën ka kaluar dhe po kalon industria e transportit ajror që nga marsi 2020 kur OBSH ka shpallur gjendjen e pandemisë globale;

AAC-ja ka vendosur se:

1. Tarifa njësi terminale për vitin 2023 është 380 EUR;
2. Nën parashikimin prej 7% të rritjes së numrit të njësive të shërbyera terminale gjatë vitit 2023 në krahasim me vitin 2022, kostot që pritet të mbulohen nga tarifa terminale e navigacionit janë 5.6 milion EUR. Kostot tjera do të mbulohen nga të hyrat tjera të ASHNA. Pra, kostot totale të ASHNA për të dhënë shërbim cilësor dhe të sigurt gjatë vitit 2023, të pranueshme nga AAC, pritet të jenë 5.98 milion EUR.

Duke marrë parasysh faktet e cekura më lartë, dhe në pajtim me nenin 15.1 (f), 81 të Ligjit nr. 03/L-051 për aviacionin civil, nenin 20 të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, si dhe në përputhje me Rregulloren (AAC) nr. 3/2016 mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil të Republikës së Kosovës ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Udhëzim mbi mjetin juridik: Në përputhje me nenin 15.7 të Rregullores nr. 3/2016, brenda 7 ditëve nga data e lëshimit të këtij Vendimi, ASHNA mund të ri-dorëzojë për miratim në AAC propozimin e ri për tarifën njësi terminale për vitin 2023 përmes Tabelave të Raportimit dhe narrativit që përshkruan në hollësi kalkulimin e secilës prej kostove të pranueshme dhe dëshmon nevojën për t'u realizuar këto kosto gjatë vitit 2023. Propozimi i ri duhet të dërgohet në original të shtypur dhe në kopje elektronike në AAC.

Iu dërgohet:

- Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror;
- Ministrisë të Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
- Komitetit të kompanive ajrore në ANP "Adem Jashari"
- Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, MFPT
- Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari"
- Arkivit të AAC-së